



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I80-2 Prot.
Nr. Dok. 202503603/2

Tiranë 03__/_11__/_2025

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë Devoll

Drejtuar: Z. Altin GUSHO
Shef i Komisarimit të Policisë

DEVOLL

Për dijeni: Drejtues i Parë Z. Erion AHMETI
Drejtues i Drejtorisë Vendore të Policisë

KORÇË

Të nderuar zotërinj,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisaratin e Policisë Devoll nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu inspektimin në Komisaratin e Policisë Devoll, në datën 07.10.2025 sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe z. Vullnet Topalli, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të shoqëruarve/ndaluarve/arrestuarve, të cilat ju garantohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit", aktet nënligjore, si dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria. Inspektimi ishte paparalajmëruar.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin

e procedurave standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, si dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi inspektues u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë Devoll z. Altin Gushe, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Gushe informoi grupin e inspektimit për gjendjen në të cilën ndodhen ambientet e shoqërimit pranë këtij komisarati, angazhimin e punonjësve të policisë që kryejnë detyrën në këto ambiente, për garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e policisë, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i inspektimit, i shoqëruar nga shefi i komisarariatit, vijoi inspektimin në ambientet e shoqërimit të komisarariatit, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, si dhe këqyri e kontrolloi plotësimin sipas rubrikave të regjistrit ku evidentohen të dhënat e personave të shoqëruar/të ndaluar apo të arrestuar, librin e kërkesë/ankesave, regjistrin për të miturit në konflikt me ligjin, plotësimin e modelit të formularit të shoqërimit, si dhe ruajtjen dhe administrimin e kopjeve të procesverbaleve të shoqërimit.

Gjithashtu, z. Gushe angazhoi edhe punonjësit e policisë së ambienteve të shoqërimit të këtij institucioni që të ishin prezent për të bashkëpunuar dhe për të shërbyer në vijim të procesit të inspektimit. Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin me punonjësën përgjegjëse të dhomës së shoqërimit, që na u bashkua gjatë evidentimit të kushteve të ambienteve të Komisarariatit të Policisë Devoll.

Theksojmë se, Përgjegjësi i dhomave të shoqërimit dhe punonjësit e tjerë të policisë, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit.

Në Komisariatin e Policisë Devoll, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2024¹, rezultoi se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin me korrektësi të rubrikës “Njoftimi i familjarëve” tek Regjistri i personave të shoqëruar dhe evidentimin e tyre në këtë regjistrë.

¹ Dërguar rekomandimi nr. K4/I71-2 prot, datë 23.10.2024 “Për inspektimin e kryer në ambientet e shoqërimit në Komisariatin e Policisë Devoll”.

2. Ishte zbatuar rekomandimi, për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore personave të shoqëruar që në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:

3. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisaritit të Policisë Devoll, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjitoze, si për personat e shoqëruar, ashtu edhe për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.
4. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, ky ambient të jetë i pajisur me kamera audio/vizive si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë së komisariatit.
5. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
6. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për ndërtimin e një tualeti të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisaritit të Policisë Devoll, për shtetaset gra të shoqëruara, ndaluara/arrestuara në konflikt me ligjin.
7. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
8. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese brenda dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Devoll, sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.
9. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për afishimin në ambientet e dhomave të shoqërimit, të listës së përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluar/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokatët kryesisht.
10. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut Tiranë.

Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se disa rekomandime kërkojnë ndërhyrje infrastrukturore dhe buxhetore që nuk varen nga njësia vendore, por çdo komisariat duhet të demonstrojë se ka qenë konsekuent në kërkimin e fondeve dhe vërejmë me keqardhje të thellë se disa të tjera lidhen me qasjen bashkëpunuese të drejtuesve ndaj rekomandimeve, ndonëse të pranura dhe të përsëritura disa herë nga ana jonë. Ndërkohë, ka edhe rekomandime që

kanë ndikim të qenësishëm në jetën e të shoqëruarve/ndaluarve/arrestuarve të cilat nuk kanë asnjë implikim buxhetor, dhe për pasojë moszbatimi i këtyre të fundit është i pajustificueshëm.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisaratin e Policisë **Devoll**, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisaratin e Policisë Devoll, ambienti i shoqërimit ishte i ndërtuar përgjithësisht sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, dhe procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e Policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, ku parashikohet se: “Dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit”².

Komisariati i Policisë Devoll funksiononte në një godinë të vjetër, por të **mirëmbajtur**. Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës dhe kishte 3 (tri) dhoma shoqërimi, të cilat ndaheshin përkatësisht në: një (1) dhomë shoqërimi për meshkujt madhorë, një (1) dhomë shoqërimi për gra dhe një (1) dhomë shoqërimi për të mitur³.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve dhe ishin të pajisura me tavolina dhe stola të fiksuara në dysHEME për të mundësuar qëndrimin ulur të personave. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x4m me kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri në 4 persona.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Dhomat gjithashtu, kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dera ishte prej druri, me mundësi për t’u mbyllur nga jashtë. Në përgjithësi dhomat ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej vetëm një tualet, i pajisur me çezmë, që kishte ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Tualeti plotësonte kushtet higjieno-sanitare dhe ishte i pastër. Në ambientet e këtij komisarati mungonte tualeti për gra, duke mos garantuar standardin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e Policisë”⁴.

² Kreu VII, pika 4 e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, parashikon, se kur nuk plotësohen këto standarde për mbajtjen e personave të shoqëruar në ambientet e policisë, krijohen kushte të nevojshme, të përshtatshme, të ndryshme nga ato të dhomave të sigurisë ku garantojnë sigurinë dhe trajtimin njerëzor i tyre.

³ “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin Nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

⁴ Kreu VII, pika 4/e2 të procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” ku përcaktohet se: “Pranë dhomave të shoqërimit dhe me to ndërtohet dhe funksionojnë tualetet për kryerjen e nevojave personale të ndara për femra dhe meshkuj me sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve përkatëse dhe funksionimin për qëllimin që kanë, me sipërfaqe 6- 8m²”.

Në Komisarlatin e Policisë Devoll, kishte një dhomë më vete e cila shërbente si dhomë e marrjes së provave materiale dhe sipas informacionit të drejtuesve të komisarlatit, provat materiale futen në një qese të etiketuar në këtë ambient⁵.

Në Komisarlatin e Policisë Devoll kishte gjenerator funksional për furnizimin me energji elektrike në rast defektesh. Ambientet e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje/ftohjeje.

Në koridoret e dhomave të shoqërimit ishin të instaluara 2 kamera për mbajtjen në vëzhgim të këtij ambienti, por ato mungonin brenda dhomave të shoqërimit për monitorimin e personave të shoqëruar në këtë insitucion. Instalimi i sistemit të kamerave të sigurisë brenda dhomave të shoqërimit do të shërbejë për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe dhomave të shoqërimit, si dhe do të monitorojë veprimet që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar gjatë kryerjes së procedurave që nga hyrja në mjediset e policisë, qëndrimit në dhoma, si dhe gjatë marrjes në pyetje të tyre.

Në kushtet e vendndodhjes së komisarlatit, si dhe për të garantuar sigurinë e personave të shoqëruar, është i domosdoshëm instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit siç parashikon Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku thuhet se: *“Të gjitha ambientet e shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përfshijë tualetin) si ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit, korridorit i tyre dhe pjesen e jashtme të dhomave të shoqërimit, të cilat lidhen dhe trasmentojnë pamje/imazhe në monitor të vendosur në ambientin e shoqërimit të sallës së komandimit/shërbimit të informacionit DPV komisarlate, stacione policise”*.

Gjatë inspektimit u evidentua se situata me njohjen e të drejtave ishte përmirësuar dukshëm në këtë komisarlat, ku në korridorin e ambientit të shoqërimit ishin vendosur posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, të cilët ishin të afishuar edhe brenda dhomave të shoqërimit, me qëllim që të jenë të aksesueshëm nga personat e shoqëruar për t'u njohur me këto të drejta në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja. Në korridorin e ambientit të shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Gjithashtu, në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa.

Në Komisarlatin e Policisë Devoll, gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 07.10.2025 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **107** persona të gjithë madhorë, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 dhe 25/1 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”. Në momentin e inspektimit, **nuk kishte asnjë shtetas** të shoqëruar në dhomat e shoqërimit.

⁵ Neni 215 i Kodit të Procedurës Penale “Vulosja e sendeve të sekuestruara”.

Nga komunikimi me punonjësit e shërbimit në zyrën e informacionit, konstatuam se personave të shoqëruar ju jepej një kopje e kartës me të drejtat e tyre në momentin që ata hynin në dhomat e shoqërimit.

Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me *“Kartën e të drejtave”* në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisariat policie. Nëpërmjet *“Kartës së të drejtave”* qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.

“Karta e të Drejtave” i shërben jo vetëm qytetarit, por edhe vetë Policisë së Shtetit, për të mirëmbajtur besimin e qytetarëve tek ajo, për ta forcuar bindjen se ajo është një instrument profesional shërbyes dhe jo dhunues i qytetarëve, si dhe për të evidentuar e veçuar abuzuesit me uniformën e policisë.

Vendosja në dispozicion të çdo qytetari të *“Kartës së të Drejtave”* është një standard të cilin Avokati i Popullit kërkon vazhdimisht që të respektohet. Gjithashtu edhe Komiteti për Parandalimin e Torturës në vijim (CPT)-ja, i cili e përshëndeti zhvillimin e kësaj praktike për kartën dhe thellimin e saj, duke kërkuar që punonjësit në zyrën e pranimit të sigurohen që të shoqëruarit duhet të shkruajnë e lexojnë dhe e kuptojnë përmbajtjen e kartës.

Në strukturën organike të Komisarariatit të Policisë Devoll janë 3 specialistë policie, që kryejnë funksionin e OPGJ-së për rastet e hetimit të veprave të rënda penale dhe njëkohësisht ata kryejnë veprimet procedurale të marrjes në pyetje të personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar. Në këtë institucion kishte 2 zyra pune të OPGJ-ve dhe nga inspektimi i këtyre zyrave, nuk u gjendën sende apo mjete që ekspozojnë dhunë te personat e shoqëruar gjatë intervistimit apo marrjes në pyetje të tyre.

Gjithashtu, në katin e dytë të Komisarariatit të Policisë Devoll, ndodhej një dhomë e cila shërbente si zyrë pune për Specialistin e Policisë së Zonës (SPZ). Ky ambient ishte i pajisur me tavolinë, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orënditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë, por nuk kishte të instaluar kamerat e monitorimit⁶.

Nga verifikimi i regjistrimit të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin **2025**, nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

⁶ Kreu VI, Pika 4/g, procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Më tej u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisariatit, mbareshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatit të Policisë Devoll nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë së Korçës.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatit të Policisë Devoll, “*Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar*” ishte i tipit “*Model nr. 1*” konform me procedurat standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*” miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme **nga 1 orë deri në 5 orë** në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit⁷ dhe ishte i sekretuar.

Në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, por gjatë vitit 2025 nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë nga ana e këtyre personave.

Gjithashtu, në këtë institucion mbahej një regjistër për të miturit e shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë periudhës janar-tetor 2025 nuk kishte të shoqëruar të mitur në konflikt me ligjin, sipas procedurës standarde (Lidhja model 5).

"Formulari i Raportit të Shoqërimit" plotësohej gjithashtu nga punonjësi i policisë që kishte kryer shoqërimin e personit për në komisariat, sikurse përcaktohet në procedurën standarde.

Gjithashtu, "Procesverbalin me veprimet e kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar", në përfundim të veprimeve, kur shtetasi lihej i lirë, punonjësi i policisë e plotësonte atë në dy kopje, ku një kopje i jepej personit të shoqëruar, ndërsa kopja tjetër e procesverbalit, pasi administrohej nga punonjësi i informacionit, mbahej në dosje të veçantë dhe pas një jave dorëzohej në sekretari/arshivën e institucionit.

⁷ Kreu VII, e procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

Në zyrën e informacionit, ndodhej edhe një regjistër për takimet me avokatin kur kërkohet nga të shoqëruarit, si dhe karta e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja.

Avokati i Popullit thekson se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor në funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Ambientet e intervistimit

Në Komisaratin e Policisë Devoll oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre, të cilat nuk ishin të monitoruara me sistem monitorimi me kamera. Ndërkohë, në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore

Në lidhje me ambientet e intervistimit, Avokati i Popullit në zbatim edhe të rekomandimeve të CPT-së, ka rekomanduar në vijimësi marrjen e masave për krijimin e zyrave për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente. Nga inspektimet periodike që zhvillon MKPT-ja në Drejtoritë dhe Komisaritet e Policisë, konstatohet se ky rekomandim nuk është plotësuar⁸

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar të arrestuar/ndaluar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ashtu dhe ndaj atyre të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve.

Gjithashtu, shërben edhe si provë nëse ndodh një gjëndje si dhunë fizike, torturë, raste fatale të vdekjeve për të verifikuar nëse i shoqëruari/ndaluari apo i arrestuar, ka qenë apo jo i dhunuar para se të ndalohej në komisaritet.

Gjithashtu, në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit⁹ ku citohet se: *“Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga*

⁸ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”.

⁹ Electronic recording of police interview (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtme fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare”.

CPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Komisariati i Policisë Devoll në kushtet aktuale nuk posedonte hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Edhe në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*”.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Sipas informacionit, përgjithësisht avokati paraqitej në mjediset e policisë jo më vonë se 1 orë nga momenti i njoftimit nga personeli i shërbimit ose nga specialistët e policisë të ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale me të shoqëruarin apo të arrestuarin, e dyshuar për kryerjen e veprës penale.

Përgjatë inspektimit në Komisariatin e Policisë Devoll, **u konstatua se nuk kishte një listë të afishuar në ambientet e komisarariatit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht, si dhe nuk ishte evidentuar në regjistrin e informacionit nëse avokatët kishin qenë të pranishëm.** Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

CPT-ja bën rekomandime të hartuara për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Gjithashtu kërkohet veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. CPT-ja gjatë vizitës në organet e Policisë së Shtetit ka konstatuar se: *“Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar për avokat kryesisht vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati”*¹⁰.

Përgjatë inspektimit punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të shoqëruarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Gjithashtu, u evidentua se në mjedisin e shoqërimit mungonte edhe lista e psikologëve e miratuar nga Urdhri i Psikologut në Tiranë. Pavarësisht kësaj, në rastet kur i shoqëruari ishte i mitur, psikologu sigurohej nga bashkëpunimi me Bashkinë dhe Shkollën e Mesme të qytetit në Devoll. **Mekanizmi Kombëtar kërkon që avokati dhe psikologu të jenë të pranishëm**, që në momentin e hyrjes të të shoqëruarve në komisariat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre dhe mbështetje psikologjike në rrethanat në të cilat këta shtetas ndodhen në institucion.

Në raste kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në qendrën Shëndetësore Devoll, për të marrë ndihmën mjekësore.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstrukcionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Devoll, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjitoze, si për personat e shoqëruar, ashtu edhe për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.
2. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, ky ambient të jetë i pajisur me

¹⁰ <https://rm.coe.int/1680ae233b>, fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

kamera audio/vizive si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë së komisariatit.

3. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e një tualeti të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Devoll, për shtetaset gra të shoqëruara, ndaluara/arrestuara në konflikt me ligjin.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese brenda dhomave të shoqërimit në Komisarariatit të Policisë Devoll, sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.
7. Marrjen e masave për afishimin në ambientet e dhomave të shoqërimit, të listës së përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluar/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokat.
8. Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut Tiranë.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI

dv